



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
Bordi i Administrimit

Nr. 964 Prot

Shkodër, më 11.03. 2024

V E N D I M

Nr. 79 datë 11.03.2024

“ PËR MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR TË AUDITIMIT DHE PYETSORIN E VETËVLERËSIMIT PËR VITIN 2023”.

Në zbatim të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me urdhërin nr. 100 datë 25.10.2016 të MF, i ndryshuar me urdhër nr. 4 datë 10.01.2020, shkresës nr.1050 Prot. datë 06.02.2024 të MF “Mbi Raportin e veprimtarisë të Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe Pyetsorin e Vetëvlerësimit për vitin 2022”, bazuar në shkresën nr.444 prot datë 08.02.2023 nga NJAB, Bordi i Administrimit me vendim qarkullues:

V E N D O S I:

1. Miratimin e Raportit Vjetor dhe Pyetsorin e Vetëvlerësimit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2023 (bashkengjitur materiali).
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Prof as.dr. Adrian LEKA







REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
Njësia e Auditit të Brendshëm

RAPORTI VJETOR

PËR

VEPRIMTARINË

E NJËSISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

PËR PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2023

SHKURT 2024



STRUKTURA E RAPORTIT VJETOR

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

II. BAZA LIGJORE

III. ORGANIZIMI

- ❖ Misioni i auditimit të brendshëm.
- ❖ Organizimi i NJAB.

IV. REZULTATET E VEPRIMTARISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

- ❖ Analiza e programeve të auditimit për periudhën raportuese.
- ❖ Analiza e misioneve të auditimit.
- ❖ Fushat me risk të lartë dhe trajtimi i tyre.
- ❖ Gjetjet kryesore sipas sistemeve.
- ❖ Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm.
- ❖ Çështjet e dërguara për investigim.

V. REKOMANDIMET.

- ❖ Rekomandimet e propozuara.
- ❖ Përgjigjia dhe reagimet e menaxhimit.

VI. MONITORIMI I SISTEMIT DHE SIGURIMI I CILËSISË

VII. ANALIZA E KAPACITETEVE AUDITUESE

- ❖ Probleme të konstatuara në lidhje me funksionimin e NJAB.
- ❖ Kapacitetet audituese.
- ❖ Zhvillimi i aftësive dhe ngritja nivelit profesional të audituesve.

VIII. KONKLUZIONE

- ❖ Konkluzione mbi problematikën e punës audituese.
- ❖ Prioritetet për vitin e ardhshëm.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Mbi Analizën e veprimtarisë së auditimit të brendshëm gjatë vitit 2023

Qëllimi i raportit është të ofrojë një përmbledhje të veprimtarisë audituese për periudhën Janar–Dhjetor 2023, detyrë e njësisë auditimit, në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr.114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, bazuar në planin vjetor të miratuar nga Bordi i Administrimit me Vendim Nr. 3107 Prot , datë 14.10.2022 për miratimin e “Planit Strategjik dhe Vjetor të Veprimtarisë së Auditit të Brëndshëm të USH-së për periudhën 2023-2025”.

Raporti vjetor i veprimtarisë së Njësisë së Auditimit të Brëndshëm në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi” paraqet në mënyrë të përmbledhur veprimtarinë e Nj.A.B. për vitin 2023.

Në zbatim të Ligjit, standarteve profesionale, praktikave më të mira të auditimit të brendshëm, në kuadër të zbatimit të planit strategjik dhe vjetor dhe arritjes së objektivave të vendosura nga kjo strukturë është synuar mbështetja e menaxhimit nëpërmjet vlerësimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Auditi i Brëndshëm si veprimtari e pavarur ka synuar mbështetjen e menaxhimit të subjektit publik për arritjen e objektivave, duke ofruar siguri objektive dhe këshillim ,duke nxitur ndryshime që përmirësojnë veprimtarinë e menaxhimit dhe rritjen e përgjegjshmërisë. Nj.A.B ka ushtruar veprimtarinë audituese, në zbatim të Ligjit 114/2015 datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brëndshëm në Sektorin Publik” brenda autoritetit, objektit dhe sipas përgjegjësisë e të drejtave të parashikuara në këtë ligj dhe kuadrit rregullator në fuqi.

Rezultatet dhe produktet e veprimtarisë së auditimit të brendshëm të pasqyruara në raportin e auditimit janë detajuar e analizuar gjatë gjithë hartimit të këtij raporti i cili në vetvete përbën një analizë të nivelit aktual të auditimit të brendshëm përgjatë kësaj periudhe audituese.

Në këtë dokument jepen opinionet e përgjithshme të kësaj strukture mbi çështje të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, menaxhimit të riskut, proceseve të qeverisjes kryesisht për fushat e auditimit të cilat janë audituar nga kjo strukturë përgjatë vitit 2023. Raporti përshkruan statusin, autoritetin, strukturën organizative dhe burimet e njësisë së auditimit të brendshëm.

Rekomandimet e dhëna për sistemet e audituara kanë synuar përmirësimin e dobësive që gjencrojnë apo krijojnë mundësinë e shkeljeve apo mashtrimeve.

Përmirësimi i vazhdueshëm i kuadrit ligjor dhe procedurial i auditimit të brendshëm, është shoqëruar vazhdimisht me rritjen e përpjekjeve për rritjen e ndërgjegjësimit mbi rolin dhe përfitimet nga auditimi.

Në këtë drejtim theksojmë se Njësisë së Auditimit të Brëndshëm i del detyrë për të ndërgjegjësuar Menaxhimin për rolin dhe qëllimin që ka në vetvete Nj.A.B.

Ngritja e cilësisë së punës audituese mbetet kërkesë dhe objektivi jonë , i cili do të ndikojë në forcimin e bindjes, kuptimit dhe sigurimit të mbështetjes nga menaxhimi. Ky është dhe mbetet një nga faktorët kyç të veprimtarisë audituese në zbatim të standarteve ndërkombëtare të auditimit te brendshëm në sektorin publik.

Gjatë vitit 2023, Auditi i Brëndshëm ka kryer auditime të cilat i janë përmbajtur planit vjetor dhe objektivave të përcaktuara në planin strategjik.

Gjatë kësaj periudhe janë kryer 3 (tre) angazhime auditimi të kombinuara (përputhshmërisë dhe financiar), 3(tre) angazhime auditim përputhshmërie në 8 fushat e parashikuara në planin vjetor si dhe 1(një) auditim i kombinuar (përputhshmërisë dhe financiar) në proces filluar në muajin dhjetor 2022 dhe mbaruar në janar të vitit 2023,



Kryerja e angazhimeve të auditimit për vitin 2023 deri në këtë periudhë nga 8 auditime të parashikuara për vitin 2023 janë realizuar rreth 80% .



Auditime të kombinuara përputhshmërisë dhe financiar:

- 1- Auditimi i përjashtim/reduktim nga tarifa e shkollimit për vitin 2022-2023
- 2- Përdorimi i fondit të bursave 2022-2023
- 3- Auditimi i menaxhimit të fondeve të akorduara nga BE dhe donatorët e tjerë për vitin 2022.
- 4- Sistemi i bursave për vitin 2021-2022 (auditimi i mbartur në proces nga dhjetori vitit 2022-janar 2023).

Auditimi i Përputhshmërisë:

- 1- Sistemi i funksionimit dhe mirëmbaja e dokumentacionit. Sistemi i inventarizimit dhe klasifikimi i librave.
- 2- Vlerësimi i detyrimeve të prapambetura.
- 3- Zbatimi i rekomandimeve.

Ky raport fokusohet në komunikimin e rezultateve të arritura nga NJAB për periudhën raportuese si më sipër dhe përmban problemet më të rëndësishme të identifikuara dhe të trajtuara, tregon ecurinë drejt përmirësimeve të vazhdueshme, si dhe sfidat dhe përpjekjet e pandërprera për të siguruar pajtueshmërinë me kuadrin legjislativ të parashikuar e në Standardet Ndërkombëtare të pranuara.

Në këtë dokument janë pasqyruar opinionet e auditimit të brendshëm mbi çështje të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, menaxhimit të riskut, proceseve të qeverisjes së subjektit publik etj. Këto vlerësime argumentohen dhe arsyetohen me përshkrimin e procedurave të ndjekuara të cilat kanë çuar në arritjen e këtyre opinionëve. Raporti përshkruan statusin, autoritetin, strukturën organizative dhe burimet, duke u bazuar në procesin e planifikimit mbi bazë risku të përdorur gjatë veprimtarisë së auditimit të brendshëm, mbi bazën e të cilit janë dhënë opinionet.

Gjetjet kryesore janë konstatuar në sistemin përjashtim/reduktim nga tarifa e shkollimit dhe përfitim burse për vitin 2022-2023: Aplikimet e studentëve duhet të pranohen të plota me të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas VKM-së në fuqi Shqyrtimi i dosjeve të studentëve nga komisioni ad-hoc duhet të bëhet brenda 15 ditëve nga dorëzimi i dokumentacionit. Brenda këtij afati duhet të kryhen të gjitha verifikimet e nevojshme për plotësimin e tij në bashkëpunim me institucionet të cilat kanë detyrim ligjor për të konfirmuar dokumentacionin dhe i dërgojnë për shqyrtim dhe miratim në Bordin e Administrimit. Çdo student duhet të dorëzojë vërtetimin e studentit ku tregohet viti i regjistrimit në programin e studimit, viti i studimit, dhe rastin nëse është stazhier për efekt të përfitimit të bursës përjashtim/reduktimit të tarifës. Të ketë afate për dorëzimin e dokumentacioneve dhe konfirmimin e frekuentimit të studentëve. Për studentët ekselent që përfitojnë bursë me mesatare 9-10 të sillen në kohë shkresat e fakultetit për verifikim dhe konstatim nga komisioni ad-hoc.

Sistemi i funksionimit dhe mirëmbajtja e dokumentacionit në Bibliotekën e Ush-së. Inventarizimi: Inventarizimi i librave në bibliotekën e USH-së ka filluar, janë evidentuar problematikat por nuk është

përfunduar plotësisht duke nxjerrë një rezultat konkret dhe finalizues nga komisioni i cili vazhdon të jetë në proces zbatimi.

Regjistri i riskut për sistemet e audituara në USH, ka nevojë për përmirësim si në strukturë ashtu dhe në përmbajtje, në mënyrë që të paraqesë sa më realisht riskun e mjedisit të kontrollit.

Duke iu referuar gjetjeve të auditimit, janë përcaktuar edhe rekomandimet në plan veprimin përkatës, për çdo raport auditimi.

Nga ana e menaxhimit plan veprimet për rekomandimet e lëna, kanë ardhur të plotësuara sipas kërkesave dhe në zbatim të manualit të auditimit të brendshëm.

II. BAZA LIGJORE

a) Baza ligjore në të cilën është mbështetur veprimtaria e Sektorit të Auditimit të Brendshëm në USH, përbëhet nga:

- Ligji Nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" dhe Manualit të Auditimit.
- Manuali i Auditimit të Brendshëm Publik, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 "Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".
- Ligji nr.9936, datë 26.06.2008, "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë".
- VKM nr.50 datë 05.02.2014 "Për miratimin e Strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimtaria",
- Udhëzim nr. 37, datë 06.10.2020 "Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme".
- VKM Nr. 269 datë 29.03.2017 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit", i ndryshuar (me VKM, Nr.779, datë 26.12.2018, VKM, Nr.698, datë 21.11.2018, VKM Nr. 40, datë 23.01.2019 dhe VKM nr.251, datë 27.03.2020)
- VKM Nr. 288, datë 21.5.2018 " Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë" ndryshuar me VKM Nr. 723, datë 06.12.2018 dhe VKM Nr. 778, datë 26.12.2018.
- VKM nr. 780, date 26.12.2018 "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë".
- Ligji nr.7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar. Akte nënligjore dhe akte administrative në zbatim të bazës ligjore, si më sipër.
- Ligji nr. 10 296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar;
- Udhëzimit nr. 27 datë 29.12.2017, për "Strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë".

5


b) Kuadri Ligjor Ndërkombëtar

Kuadri i Praktikave Profesionale Ndërkombëtare i cili përmban Standartet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm dhe Praktikave Profesionale të publikuara nga IIA përbëjnë bazën e paketës ndërkombëtare të zbatueshme për auditimin e brendshëm në Shqipëri. Ne vazhdimisht jemi munduar të auditojmë në mënyre sistematike duke rekomanduar përmirësime për parregullësitë e konstatuara, të cilat janë të realizueshme dhe në funksion të përmirësimit të sistemit.

Të ndryshme: Udhëzime, Udhëzues, Urdhëresa dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore në zbatim të ligjeve, vendimeve, urdhërave në fuqi, statutit dhe rregulloreve të USH-së.

III. ORGANIZIMI

Misioni i auditimit të brendshëm

Misioni i auditimit të brendshëm është të mbështesë menaxhimin e lartë për arritjen e objektivave të tyre. Këtë mision ai e realizon duke:

- ✓ Kryer vlerësime të pavarura të sistemeve të kontrollit të brendshëm financiar të vendosura nga menaxhimi.
- ✓ Synuar ruajtjen e një ambjenti bashkëpunues, me qëllim stimulimin e rritjes së nivelit profesional të audituesve.
- ✓ Ofruar analiza, rekomandime, këshillime dhe informacione lidhur me veprimtaritë që ai ka vlerësuar.

Detyrat dhe përgjegjësitë e Zyrës së Auditimit të Brendshëm konsistojnë në:

- ✓ Organizimin dhe mbikëqyrjen e ushtrimit të të gjitha aktiviteteve të auditimit të brendshëm. si dhe dorëzimi i rezultateve të auditimit menaxhimit të lartë;
- ✓ Sigurimin e zbatimit adekuat dhe respektimit të ligjeve, rregullave, politikave dhe udhëzimeve të përcaktuar me Ligjin mbi Auditimin e Brendshëm;
- ✓ Përgatitjen dhe dorëzimi në kohë i planit strategjik të auditimit në bazë të vlerësimit të rrezikut për rishikim dhe miratim të menaxhimit të lartë;
- ✓ Informimin i menaxhimit të lartë në lidhje me funksionin e auditimit të brendshëm, i bazuar në modelin e siguruar nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm.

Misioni i AB përcakton synimet kryesore të njësisë së auditimit të brendshëm dhe fushat që mund të jenë subjekt i punës së auditimit.

Kryerja e çdo angazhimi auditimit në përputhje me aktet ligjore nënligjore në fuqi, standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm të pranura dhe shpallura nga Ministri i Financave, të planit të konsoliduar strategjik e vjetor të veprimtarisë së auditimit të brendshëm në njësitë publike.

Auditimi i brendshëm duhet të asistojë të gjitha nivelet e menaxhimit në kryerjen efektive të përgjegjësisë të tyre, nëpërmjet analizave të pavarura, vlerësimeve, këshillimeve dhe rekomandimeve, lidhur me veprimet e ekzaminuara.

Misioni i auditimit të brendshëm është të japë siguri të arsyeshme për titullarin e njësisë publike në mënyrë të pavarur dhe objektive, këshilla për përnirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësinë e sektorit publik.

Sipas përcaktimit të bërë në Ligjin për AB, auditimi i brendshëm është një veprimtari e pavarur, që jep siguri objektive dhe këshilla për menaxhimin, e projektuar për të shtuar vlerën dhe për të përmirësuar veprimtarinë e njësisë publike. Ai e ndihmon njësinë publike për të arritur objektivat, nëpërmjet një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike për të vlerësuar e për të përmirësuar frytshmërinë e menaxhimit të riskut, proceset e kontrollit dhe të qeverisjes. Auditimi i Brendshëm ndihmon institucionin të arrijë objektivat e veta, nëpërmjet rekomandimeve për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e kontrollit të brendshëm, menaxhimit e riskut si dhe proceset e qeverisjes.

Organizimi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm në USH

Struktura e Auditimit të Brendshëm në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi" është bazuar në Ligjin për Auditimin e Brendshëm, Manualin e Auditimit, Kartën dhe Kodin e Etikës për audituesit dhe ushtron veprimtarinë e saj nëpërmjet implementimit të Planit Vjetor i cili përcakton qartë objektivat për t'u arritur, kapacitetet në dispozicion si dhe vlerësimin e menaxhimit të riskut. Kjo strukturë është e plotësuar me tre auditues si një kërkesë e ligjit për ngritjen dhe funksionimin e Nj.A.B në sektorin Publik sipas miratimit të strukturës organike me vendim të Senatit me nr 33 Prot. Datë 09.01.2023 për "Detajimin e Grantit 2023 dhe strukturës në USH". Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2023 Nj.A.B ka funksionuar jo me kapacitetet e duhura sipas strukturës së miratuar por me 2 punonjës (Drejtues + Specialist) ndërsa gjatë gjashtëmujorit të dytë me datën 1 korrik 2023 në vazhdim njësia është plotësuar me (1+2) drejtuesi i njesisë i Certifikuar dhe 2 specialistë në pritje të hapjes së procesit të certifikimit. të dy specialistet zotërojnë një certifikatë trajnimi nga Instituti I Ekspertëve Fiskal të formimit profesional për Audit të Brendshëm.

IV. REZULTATET E VEPRIMTARISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

1. Analiza e programimeve të auditimit për periudhën Janar 2023 – Dhjetor 2023

Plani strategjik dhe vjetor 2023-2025 i veprimtarisë së auditimit të brendshëm , miratuar nga Bordi i Administrimit të Universitetit Shkodër "Luigj Gurakuqi" me Vendim Nr. 3107 Prot , datë 14.10.2022, dhe me shkresën nr.3026/1 prot, datë 17.10.2022 është dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Sipas planit vjetor të angazhimeve nga NJAB për vitin 2023 (Pasqyra nr.3) për periudhën raportuese janë planifikuar 8 shërbime të sigurisë, të ndara sipas llojit të tyre ;

- 3 Auditime të përputhshmërisë,
- 5 Auditime të kombinuara





Parashikuar në subjektet si më poshtë paraqiten:

1	Drejtoria Ekonomike, sekretariatë mësimore	Auditimi për përjashtim/reduktim nga tarifa e shkollimit për vitin akademik 2022-2023.
2	Drejtoria Ekonomike, sekretariatë mësimore	Përdorimi i fondit të bursave për vitin 2022-2023
3	Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Shërbimeve dhe Prokurimeve	Auditimi i Procedurës së Prokurimeve të fondeve publike dhe hlerjet e vogla 2021-2022
4	Fakultetet, Drejtoria Ekonomike, 1. Drejtoria e Kurrikulave, Kërkimit Shkencor dhe Standarteve, Drejtoria Juridike dhe e Burimeve Njerëzore	Auditimi i pedagogëve të jashtëm dhe realizimi i normës së ngarkesës mësimore.
5	Drejtoria e Bibliotekës Shkencore	Sistemi i funksionimit dhe mbajtja e dokumentacionit Sistemi i inventarizimit dhe klasifikimit të librave.
6	Drejtoria Ekonomike, Sektori i Komunikimit Marrdhënjeve me Jashtë dhe Projekteve	Auditimi i menaxhimit të fondeve të akorduara nga BE dhe donatorë të tjerë për vitin 2022
7	Drejtoria Ekonomike	Vlerësimi i detyrimeve të prapambetura
8	Rektorati, Fakultetet	Zbatimi i Rekomandimeve

Referuar Standardit 2010 të IIA-Planifikimi ku përcaktohet se : Drejtuesi i auditimit të brendshëm duhet të vendosë një plan auditimi të bazuar në rrezik për të përcaktuar përparësitë e aktivitetit të auditimit të brendshëm, në linjë me synimet e organizatës.

Standardit 2010.A1 ku përcaktohet se : Plani i angazhimeve të aktivitetit të auditimit të brendshëm, duhet të bazohet në vlerësimin e dokumentuar të riskut, të kryer të paktën një herë në vit. Në këtë proces duhet të konsiderohen edhe sugjerimet dhe të dhëna nga drejtimi i lartë dhe bordit.

Manualit të Auditimit të Brendshëm, pikës 3.5 "Rishikimi i planeve strategjike dhe vjetore të auditimit të brendshëm" ku përcaktohet se : Për arsye të ndryshme lind nevoja që të rishikohen e të bëhen ndryshime në planin e auditimit të brendshëm të një njësie, në rastet kur bëhen auditime në raste të veçanta me urdhër të titullarit.

Për periudhën raportuese Janar- Dhjetor 2023 janë kryer angazhimet si më poshtë:

Angazhime të planifikuara 6 (gjashtë)

- Drejtoria Ekonomike sekretariatë mësimore, Auditimi për përjashtim/reduktim nga tarifa e shkollimit për vitin akademik 2022-2023
- Drejtoria Ekonomike, sekretariatë mësimore, përdorimi i fondit të bursave për vitin 2022-2023

- Drejtoria e Bibliotekes Shkencore, sistemi i Funkcionimit dhe mbajtja e dokumentacionit Sistemi i inventarizimit dhe klasifikimit të librave.
- Drejtoria Ekonomike, Sektori i Komunikimit Marrdhenjeve me Jashtë dhe Projekteve, auditimi i menaxhimit të fondeve të akorduara nga BE dhe donatorë të tjerë për vitin 2022
- Drejtoria Ekonomike, vlerësimi i detyrimeve të prapambetura
- Regjorati, Fakultetet, Zbatimi i Rekomandimeve


Angazhim në process 1 (një) mbartë nga dhjetori 2021 në janar 2022.

- Drejtoria Ekonomike sekretaritë mësimore, përdorimi i fondit të bursave për vitin 2021-2022.

Plani vjetor i angazhimeve të vitit 2023, rezulton i realizuar në masën 80 %.

Në mënyrë grafike, realizimi i planit për kryerjen e auditimeve për periudhën raportuese Janar-Dhjetor 2023, paraqitet si më poshtë:

Tabela: Realizimi i planit vjetor për vitin 2023



2. Analiza e misioneve të auditimit, objektivave të auditimit

Sikurse është përmendur edhe më sipër, auditimet e kryera janë të programuara në planin vjetor të vitit 2023, Universiteti i Shkodrës "L.Gurakuqi" 6 subjekte të audituara sipas planit + 1(një) i mbartur nga vitin 2022.

Gjatë realizimit të Planit Strategjik dhe Vjetor, për periudhën raportuese janë përfshirë për auditim këto sisteme: Sistemet e proceseve organizative, të cilat përbëhen nga:

- Auditimi mbi vlerësimin e sistemit për përjashtim/reduktim nga tarifa e shkollimit për vitin akademik 2022-2023.

9



- Sistemi i vlerësimit të përdorimit të fondit të bursave, për vitin akademik 2022-2023 dhe sistemi i përdorimit të fondit të bursave për vitin 2021-2022.
- Sistemi i funksionimit dhe mbajtja e dokumentacionit Sistemi i inventarizimit dhe klasifikimit të librave
- Sistemi i menaxhimit të fondeve të akorduara nga BE. Sistemi i menaxhimit të projekteve IPA. Sistemi i raportimit dhe zbatimit të projekteve në përputhje me marrëveshjen. Sistemi pagesave dhe i transferimit të fondeve nga BE
- Vlerësimi i sistemit të detyrimeve të prapambetura
- Vlerësimi i nivelit të zbatimit të rekomandimeve

Në çdo program auditimi është përcaktuar si objektiv auditimi, dhënia e sigurisë ndaj menaxhimit të lartë, se kontrollat e brendshme po funksionojnë për përmbushjen e objektivave me kosto efektive dhe në mënyrë efikente. Në përfundim të çdo angazhimi auditimi, është bërë vlerësimi i komponentëve të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, vlerësim i cili ka qenë i përcaktuar që në programin e angazhimit, dërguar subjekteve së bashku me njoftimin për fillimin e angazhimit të auditimit sipas manualit të AB.

3. Fushat me risk të lartë/mesëm dhe trajtimi i tyre

Njësia e Auditimit të Brendshëm ka identifikuar dhe vlerësuar në Planin Strategjik dhe Vjetor risqet kryesore për veprimtarinë e tij. Metodologjia e përdorur për vlerësimin e riskut është ajo e përcaktuar në Ligjin për Auditimin e Brendshëm dhe Manualin e Procedurave dhe pikërisht bazuar në këtë sistem të vlerësimit të riskut, është programuar dhe auditimi i fushave dhe subjekteve që paraqiten me një nivel të lartë risku. Nga analiza e të dhënave vjetore sipas subjekteve të audituara nga struktura e auditimit përcaktimi i nivelit të riskut është bërë duke marrë në konsideratë faktorët e riskut të cilët në mënyrë të përmblodhur do të përgjithësojmë në kategoritë e mëposhtme:

- Organizimi dhe kompleksiteti i subjekteve;
- Kuadri ligjor dhe rregullator;
- Kërkesat e raportimit financiar;
- Mjedisi i Kontrollit;
- Shkalla e ndryshimeve organizative dhe të sistemit të drejtimit (menaxhimit);
- Materialiteti sipas vlerës – transaksionet me vlera monetare dhe/ose volum të madh;
- Risku i brendshëm i fushës apo subjektit që auditohet;
- Mbulimi i pamjaftueshëm me auditime në të kaluarën.

Nga angazhimet e realizuara në sistemet/fushat e audituara gjatë vitit 2023 janë identifikuar risqet si më poshtë, dhe për të trajtuar risqet nga grupi i punës janë lënë rekomandime me qëllim uljen e riskut dhe përmirësimin e sistemit.

TABELA NIVEL RISKU

Angazhimet	Nr rekom.	Niveli i rrisikut		
		I lartë	I mesëm	I ulët
Angazhimi 1 "Biblioteka"	1	x		
	2	x		
	3		x	
	4			x
Angazhimi 2 "Detyrimet e prapambetura"	1	x		
Angazhimi 3 "Fondet e BE dhe donatorë të tjerë në USH"	1			x
	2		x	
	3			x
	4		x	
Angazhimi 4 dhe 5 "Fondi i përdorimit bursave dhe përjashtim / reduktim tarife 2022-2023"	1		x	
	2	x		
	3	x		
	4	x		
Angazhim 6 "Bursa 2021-2022" mbart nga 2022	1	x		
	2		x	
	3	x		
	4	x		
	5	x		
Totali	18	10	5	3

Nga krahasimi i parashikimeve të bëra në plan dhe risku pas angazhimeve vihen re ndryshime të konsiderueshme në nivel risku.

Angazhimi nr 1 është parashikuar me risk të mesëm dhe rekomandimet bazuar ne gjetje rezultojne 2(dy) me risk te lartë dhe 1(një) me risk te mesëm dhe një me risk të ulët.

Angazhimi nr 2, rezultojnë me risk të lartë.

Angazhimi nr 3, është parashikuar me risk të ulët dhe rekomandimet bazuar ne gjetjet rezultojne 2(dy) risk i ulët dhe 2 (dy) risk i mesëm.

Angazhimi nr 4/5 është parashikuar me risk të lartë dhe rekomandimet bazuar në gjetjet rezultojnë 3(tre) risk i lartë dhe 1 (një) risk i mesëm.

Angazhimi nr 6 është parashikuar me risk të mesëm dhe rekomandimet bazuar në gjetjet rezultojnë 1(një) i mesëm dhe 4 (katër) të lartë.

Gjetjet kryesore sipas sistemeve

Në këtë raport do të përfshihen gjetjet e auditimit të plotë, mbi bazë sistemi, këto auditime janë raportuar si auditime të përputhshmërisë dhe financiar.

Gjatë vitit 2023 sipas gjetjeve të konstatuara dhe vlerësimit të bërë nga ana e audituesve për sitemet e kontrollit të brendshëm janë dhënë edhe rekomandimet përkatëse.

Rekomandime e lëna konsistojnë në:

- ✓ Të bëhen pasqyrat e realizimit të buxhetit të detajuar për çdo projekt për periudhën subjekt auditimi qershor 2021-dhjetor 2022.





- ✓ Çdo grup pune duhet ti paraqesë kordinatorit të projektit dokumentacionin justifikues të menaxhimit financiar mbi shpenzimet e kryera si; faturë udhëtimi, faturë akomodimi/ fjetje, ITR ose Join Declaration/time sheet, axhendën + listeprezenca dhe çdo dokument tjetër i cili kërkohet në marrëveshjen mes partnerëve. Çdo devijim/tejkallim i buxhetit në zëra duhet të jetë i justifikuar me kërkesë nga kordinatori dhe i miratuar nga Partneri Lider.
- ✓ Përmbledhësja e shpenzimeve të honorareve dhe udhëtimeve sipas bankave të firmoset nga Nëpunësit Autorizues (Administratori) Nëpunësi Zbatues (Drejtori Ekonomik) dhe të gjithë personat përgjegjës në borderonë përmbledhëse. Kursi i këmbimit duhet të jetë ditën që kryhet shërbimi/ transaksioni.
- ✓ Të zbatohen në mënyrë të saktë planet e ditëve të punës të përcaktuara në buxhet sipas fazave të zbatimit të projektit dhe kategorive të punës. Të realizohet në kohë deklarimi i tatimit në burim dhe pagesa të bëhet e plotë konform legjislacionit në fuqi. Të mirë menaxhohet buxheti (fondi në dispozicion) dhe pagesat të jenë në kohë dhe të plota.
- ✓ Të merren masa që të mbyllet procesi i inventarizimit të librave në Bibliotekën e USH-së dhe nxjerrja e një rezultati final në zbatim të urdhërit nr. 275, datë 10.07.2018.
- ✓ Të hartohet një process-verbal i detajuar me përgjegjësi materiale dhe ligjore që çdo fond ka gjëndje miratuar nga komisioni i verifikimit ngritur me një urdhër të brendshëm nga Drejtori I BUSH-së. Procesverbali në fund të procesit duhet firmosur nga komisioni i brendshëm i verifikimit dhe nga secili punonjës që është përgjegjës për fondin përkatës. Të protokollohet.
- ✓ Të ndiqet procedura për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, ursyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës, si për librat e amortizuar dhe jashtë përdorimit ashtu dhe për humbje, dëmtime dhe moskthime të librave të huazuar.
- ✓ Kërkesa për blerje të librave të bëhet pasi të merret informacioni i saktë pranë BUSH nëse biblioteka e zotëron ose jo kërkesën për librat në nevojë të përdoruesit. Kërkesa për librat në nevojë të përpilohet dhe dërgohet për miratim nga drejtuesi i BUSH-së.

Të gjitha rekomandimet janë pranuar nga ana e subjekteve të audituara. Në mënyrë të hollësishme ato janë trajtuar në materialet e auditimit dhe janë pasqyruar në Pasqyrën nr. 5 të Rportimit vjetor "Rekomandimet e dhëna nga NJAB sipas prioriteteve për periudhën Janar 2023-Dhjetor 2023". Zbatueshmëria e tyre ngelet në nivele jo të kënaqshme, në drejtim të aktiviteteve të kontrollit, nga gjetjet e konstatuara rezulton se në disa raste kanë munguar si kontrollet parandaluese, kontrollet zbuluese dhe kontrollet drejtuese.

Në përfundim të auditimit është vlerësuar se sistemi i kontrollit të brendshëm ka paraqitur dobësi në drejtim të mjedisit të kontrollit, aktiviteteve të kontrollit dhe monitorimit.

Përsa i përket komponentit të menaxhimit të riskut, duhet t'i kushtohet rëndësi menaxhimit të riskut si dhe vlerësimin e adresimit të tij të identifikuar gjatë kryerjes së procedurave.

12

KRYEMINISTRI
D. METE
KRYEMINISTRI

Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm

Kryerja e 7 (shtatë) angazhimeve të auditimit, evidentoi domosdoshmërinë e rishikimit të rregulloreve të brendshme për tu përshtatur me kërkesat e Ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, si dhe mungesën e trajnimeve të stafit në këtë fushë.

Sipas mendimit të audituesve të brendshëm është i domosdoshëm trajnimi i personelit administrativ dhe personelit ndihmës akademik, si punonjës që ngarkohen me përgjegjësi për menaxhimin ku janë të punësuar, trajnim i cili duhet të fokusohet në njohjen dhe zbatimin në praktikë të menaxhimit financiar dhe kontrollit mbi zbatimin e rregulloreve të brendshme në fuqi në USH.

Mjedisi i kontrollit – Krijimi i një mjedisi të përshtatshëm, për nivelet e ndryshme të menaxhimit, ka ndikuar ndjeshëm në rritjen e ndërgjegjësimit dhe kuptimin e saktë të rolit të sistemit të NJAB-së si mbështetje dhe ndihmë për menaxhimin e sistemit të UNISHK në përmbushjen e objektivave. VKM-të, Ligjet, Vendimet, Urdhërat, Rregulloret si dhe kriteret e përcaktuara në ligj për sistemet subjekt auditimi duhet të zbatohen me përpikmëri nga personat përgjegjës si dhe nga komisionet e ngritura për këtë qëllim.

Menaxhimi i riskut – Njësia e Auditimit të Brendshëm ka disa metoda të vlerësimit të riskut për kontrollin e brendshëm, por këto nuk janë të mjaftueshme për menaxhimin e riskut në tërësi të njësisë. Mund të theksojmë disa aspekte pozitive në këtë drejtim, si ekzistenca e një praktike të mirë diskutimi mbi risqet e mundshme gjatë procesit të përcaktimit të objektivave. Megjithatë, konstatohet se edhe në rastet kur ka procedura të menaxhimit të riskut, ato fokusohen më tepër në risqet financiare dhe jo në të gjitha llojet e risqeve që mund të paragjykojnë përmbushjen e qëllimeve. Nga auditimi në Rektorat. pavarësisht se po raportohen gjetjet dhe rekomandimet, duhet të hartohet regjistri i riskut në njësitë bazë, njësitë kryesore, të cilat duhet të jetë pjesë integrale e regjistrit të riskut në rektorat të USH. Ky proces duhet të jetë pjesë e menaxhimit të riskut të USH, i cili udhëhiqet nga nëpunësi autorizues i USH-së, që sipas pikës 1 të nenit 10 të Ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin është kordinator i menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe kordinator i riskut.

Aktivitetet e kontrollit - Referuar gjetjeve, rezultojnë se jo të gjitha aktivitetet e kontrollit kanë qenë efektive dhe nuk kanë garantuar kryerjen e veprimeve në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Nga këto auditime rezultojnë se kanë munguar jo vetëm kontrollet *parandaluese e zbuluese*, por edhe kontrollet *drejtuese*. Në drejtim të aktiviteteve të kontrollit duhet t'i kushtohet mjaft rëndësi rakordimit të të dhënave, pra të dhënat nga burime të ndryshme, duhet të rakordojnë, jo vetëm në sasi e në vlerë, por edhe me dokumentacion justifikues.

Informacioni dhe komunikimi - Informacioni i është komunikuar menaxhimit dhe punonjësve në formën dhe kohën e duhur.

Monitorimi - Nisur nga gjetjet e konstatuara nga këto angazhime auditimi, vlerësojmë se ka munguar monitorimi i vazhdueshëm sipas hierarkisë. Mungesa e monitorimit nuk ka garantuar se punonjësit i

zbatojnë përgjegjësitë e ngarkuara me efektivitet dhe aktivitetet e kontrollit po funksionojnë siç duhet. Fokusi primar i stafit duhet të jetë monitorimi i vetë punës së tyre, për t'u siguruar se e kanë kryer në mënyrën e duhur. Stafit duhet të trajnohet lidhur me aktivitetet e kontrollit të brendshëm dhe të nxitet që të jetë i vëmendshëm ndaj parregullsive dhe t'i raportojë këto parregullsi. Ndërsa pozicionet menaxheriale duhet të mbikqyrin sektorët e vartësisë, për të garantuar se punonjësit po i zbatojnë përgjegjësitë e ngarkuara me efektivitet dhe aktivitetet e kontrollit po funksionojnë siç duhet.

6. Çështjet e dërguara për investigim

Për periudhën raportuese nuk ka çështje të dërguara për investigim.

V. REKOMANDIMET

• Rekomandimet e propozuara:

Referuar misioneve të auditimit të raportuara sipas pasqyrave bashkëlidhur, rezultojnë se për misionet e realizuara gjatë vitit ushtrimor 2023 janë përcaktuar 18 rekomandime ; prej të cilave,

- 7 Rekomandime për përmirësimin e sistemeve
- 6 Rekomandime të karakterit organizativ
- 5 Rekomandim për arkëtim

✓ Përgjigja dhe reagimet e menaxhimit

Referuar Standardit 2500 "Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve", përcaktuar edhe në çështjen me nr. 4. i.13 "Ndjekja e rekomandimeve", të kapitullit IV, të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 "Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik", është kryer monitorimi i zbatimit të rekomandimeve nëpërmjet përfshirjes në çdo program angazhimi të drejtimit : Vlerësimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i fundit.

Shërbimi i Auditimit të Brendshëm si një nga prioritetet e tij ka edhe ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve, rritjen e cilësisë së tyre si dhe forcimin e bashkëpunimit me njësitë e audituara me qëllim që rekomandimet e dhëna të shërbejnë për ndreqjen e parregullsive e gabimeve dhe përmirësimin e menaxhimit dhe sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Për tu siguruar se subjektet e audituara kanë ndërmarrë të gjitha masat korrigjuese ose veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve dhe këshillave të auditimit, përveç informacioneve të drejtuesve të këtyre njësive ndjekja kryhet nëpërmjet angazhimeve të ushtruara, në programet e të cilave përfshihet edhe zbatimi i rekomandimeve të lëna në angazhimet e mëparshme, por edhe si angazhime më vete.

Subjektet e audituara kanë bashkëpunuar me Nj.A.B, për të diskutuar, pranuar dhe zbatuar rekomandimet, të cilat i referohen gjetjeve të auditimit. Për eliminimin e parregullsive dhe shkeljet e vërtetuara, me objektiv përmirësimin e veprimitarisë dhe performancës, nëpërmjet mirëfunksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, zbatimi i rekomandimeve ka filluar në disa raste dhe janë zbatuar gjatë periudhës së angazhimit të auditimit. Drejtoritë e audituara në përgjithësi i kanë pranuar të gjitha rekomandimet, njëkohësisht edhe për afatet e realizimit të këtyre rekomandimeve krahas afateve të lëna nga Nj.A.B



VI. MONITORIMI I SISTEMIT DHE SIGURIMI I CILËSISË

Referuar Standardit 1300 "Programi i Siguridhënies dhe përmirësimit të cilësisë", përcaktuar edhe në Kapitullin VII, të Manualit të Auditimit të Brendshëm, NJAB ka hartuar Programin e Sigurimit të Cilësisë, i cili është miratuar nga BA me Vendim Nr.23 datë 28.01.2022.

Rishikimi i brendshëm i cilësisë është kryer deri në nivelin e përgjegjës të grupit.

Bazuar në Ligjin e AB manualin e tij sigurimi i cilësisë është një proces i vazhdueshëm i cili fillon gjatë gjithë kohës së angazhimit të auditimit dhe vazhdon me përfundimin e tij dhe përpilimin e çdo dosje auditimi sipas kërkesave ligjore në fuqi. Në vijim të përmirësimit të vlerësimit të cilësisë Drejtuesi i Nj.A.B. do të marrë në konsideratë trajnimin e vijueshëm profesional të organizuar nga DHAB.

VII. ANALIZA E KAPACITETEVE AUDITUESE

a. Probleme të konstatuara në lidhje me funksionimin e NjAB

Sikurse është përmendur në çështjen Organizimi i NJAB, njësia e Auditimit të Brendshëm është organizuar në nivel Sektorit, me përbërjen 1 Drejtues + 2 Specialistë.

Për kryerjen e misionit dhe detyrave të ngarkuara, Njësia e Auditimit të Brendshëm ka përqëndruar vëmendjen në rritjen e nivelit profesional të audituesve në fusha të caktuara e kryesisht në atë të metodikave të auditimit financiar, menaxhimin financiar dhe kontrollin, prokurimet publike, teknologjisë së informacionit e të tjera të cilat janë programuar dhe paraqitur që në fazën e hartimit të planit strategjik dhe vjetor.


Për periudhën 1 Shkurt 2023 deri me 1 Korrik 2023 sektori ka funksionuar vetëm me Drejtuesi +1 Specialist, çka përbën një aspekt të kufizimeve të auditimit dhe funksionimit të strukturës jo sipas kapaciteteve të planifikuara të burimeve njerëzore, për shkak të kohës së nevojshme të zhvillimit të procedurave ligjore të rekrutimit të punonjësve, për plotësimin e strukturës së Sektorit me stafin e plotë, duke ndikuar dhe në realizimin e objektivave dhe misioneve të parashikuara të angazhimit.

b. Kapacitetet Audituese

Struktura e NjAB aktualisht përbëhet nga një Drejtues dhe dy Specialistë të emëruar me Vendim nr 137 Prot date 13.01.2023 Znj.Eriona Vadinaj me profesion Ekonomiste dhe me Vendim nr.1900 Prot datë 06.06.2023 Znj.Antoneta Marku me profesion Juriste, Drejtuesi zotëron certifikatën " Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik", me profesion Financier- Kontabilist si dhe fakultet të dytë me profesion Jurist. Drejtuesi ka 5 vite e 8 muaj eksperiencë në njësinë e auditimit të brendshëm në USH.

c. Zhvillimi i aftësive dhe ngritja e nivelit profesional të audituesve

Ngritja e vazhdueshme e nivelit profesional të audituesve të brendshëm, duke i mbajtur në një nivel të lartë efektiviteti dhe profesionalizmi, në mënyrë që çdo auditues të përmbushë sa më mirë misionin e tij, është jo vetëm domosdoshmëri, por edhe përgjegjësi e Njësive së Auditimit të Brendshëm. Drejtuesja e NjAB ka kryer të gjitha trajnimet e detyrueshme mbi edukimin në vazhdim, sipas kalendarit të përcaktuar nga Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm në Ministrinë e Financave. Njoftuar me shkresën Nr.3917 Prot datë 27.02.2023 nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, Drejtoria e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm. Në mënyrë të vazhdueshme NJAB ndjek dhe trajnime në fusha





të ndryshme të cilat i nevojiten si specialisteve ashtu dhe drejtuesit për zgjerimin dhe profesionalizimin e dijeve për disa fusha që janë objekt auditimi në vijimësi.

VIII. KONKLUZIONE

a. Konkluzione mbi problematikën e punës audituese.

Vlera e auditimit të brendshëm krahas vlerësimeve objektive dhe të pavarura matet nga aftësia e tij për të iniciuar dhe drejtuar përmirësime të vazhdueshme, çka do të thotë rezultate nga funksioni i auditimit të brendshëm. Gjetjet e rezultuara nga angazhimet e auditimit, për subjektet (drejtoritë e audituara zhvillimin e veprimtarisë jo në përputhje me aktet ligjore e nënligjore dhe rregulloret e miratuara) kanë ardhur nga mos funksionimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm, si rrjedhojë e mungesës së aftësive profesionale dhe përditësimit të vazhdueshëm të njohurive të punonjësve dhe trajnimit të vazhdueshëm të tyre, kryesisht në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, me qëllim menaxhimin e riskut, arritjen e objektivave, përmirësimin e performancës dhe veprimtarisë në përgjithësi.

Niveli i cilësisë së punës audituese dhe profesionalizmi i audituesve ka ndikim të drejtpërdrejtë në forcimin e rolit dhe pozitave të auditimit në subjektet e audituara. Funksioni i auditimit të brendshëm kryhet në mënyrë të dobishme dhe të frytshme vetëm nëse do të ekzistojnë aftësitë, mjetet dhe burimet e nevojshme për të mbështetur këtë funksion. Përveç sa më sipër, dëshirojmë të theksojmë edhe disa kufizime, për zgjidhjen e të cilave kërkohet mbështetje nga Menaxhimi i Lartë.

Nj.A.B do kishte lehtësime nëse çdo vendim i Senatit Akademik dhe çdo vendim i Bordit të Administrimit ti dërgohet njësisë për dijeni sepse do të ishte shumë i dobishëm në efektivitetin e shërbimit të auditimit të brendshëm. Vënia në dispozicion e një informacioni të tillë do të ndikojë në efikasitetin e kryerjes së angazhimeve të auditimit sipas planit vjetor.

b. Prioritetet për vitin e ardhshëm

Ngritja e nivelit profesional të audituesve të brendshëm, duke u trajnuar veçanërisht në drejtim të përjasjeve të reja të kryerjes së angazhimeve të auditimeve, duke iu përshtatur me fleksibilitet ndryshimeve dinamike.

Përmirësimi i performancës dhe veprimtarisë së auditimit të brendshëm, me objektiv:

- ✓ Përmirësimi i cilësisë së rekomandimeve, në mënyrë që jo vetëm të jenë të pranueshme dhe të zbatueshme, por të kenë ndikim në arritjen e produktit përfundimtar të punës audituese, thënë ndryshe: shtimin e vlerës, përmirësim të performancës dhe të veprimtarisë së subjekteve të audituara, si dhe ndjekja e zbatimit të tyre në mënyrë që veprimtaria e NJAB të kryhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
- ✓ Realizimi i planit vjetor 2024, sipas sistemeve dhe fushave të llogarive të identifikuar gjatë përgatitjes së këtij plani.
- ✓ Çertifikimi i dy specialisteve që janë pjesë e Nj.A.B. në funksion të zbatimit të kërkesave të kuadrit ligjor për auditimin e brendshëm.
- ✓ Përmirësimi i nivelit të raportimit nepermjet rritjes së cilësisë së auditimit (sigurimit të cilësisë së auditimit në çdo fazë të angazhimit).

✓ Funksionimi i strukturës me burime të mjaftueshme auditimi, në mënyrë që të arrihen objektivat e përcaktuara në Planin vjetor 2024 dhe nëpërmjet rekomandimeve të ndikojmë në përmirësimin e dobësive të sistemit të kontrollit të brendshëm, pra të shtojmë vlerë në sistemin e USH.
✓ Zbatimin e standardeve profesionale ndërkombëtare të auditimit, me qëllim rritjen e parametrave cilësorë në punën audituese.


SHKUD
UNN

Drejtuesi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm

Ruskeda BERHANI

Shkodër me Datë: 08.02.2024

NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË _UNIVERSITETIN F.SHKODRËS "LI IGJ GURAKI" QI _____



Çështjet e dërguara për investigim për vitin 2023

Nr.	Subjektet ku janë konstatuar parrregullsitë	Shkresa Referuese (nr, datë)	Natyra e parrregullsisë ose veprime që përbëjnë vepër penale	Autoriteti ku janë dërguar praktikant për ndjekje
a.	1	2	3	4
1	S'ka	---	---	---
2	S'ka	---	---	---
3	S'ka	---	---	---
4	S'ka	---	---	---
5	S'ka	---	---	---
6	S'ka	---	---	---
7	S'ka	---	---	---

Drejtnesi i NJAB Ryskeda BERHANI